



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPËSTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Data e miratimit: 31.07.2015			
Nr. i urandës:	Num. i...	Titulli...	Titulli...
Org. e...	Num. i...	Titulli...	Titulli...
02013/1065			

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36.1 dhe 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më 30.07.2015, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99 VITE) PRONËN E PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR KËSHILLIN E BASHKËSISË ISLAME NË VITI, PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN BUZOVIK

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë I JEP në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të Komunës, Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti, për ndërtimin e një xhamie në fshatin Buzovik, parcelën me nr.412-2 me sipërfaqe prej 600m² e cila gjendet në Zonën Kadastrale Buzovik.

Neni 2.

Parcela kadastrale e lartshënuara që është objekt i këtij vendimi i jepet në shfrytëzim afatgjatë pa të drejtën e dhënies me qira, pa të drejtën e nën kontraktimit me personat e tretë, me mundësi të vazhimit vetëm për destinacionin e përcaktuar më lartë dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera.

Neni 3.

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së pa luajtshme, nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti me numër 07-07/978 të datës 14.07.2015 të drejtuar Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, e Komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi i dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër,
2. Këshillit të Bashkësisë Islame
3. Shërbimit të kuvendit
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira

